

Broshurë,
3-mujori i katërt,
2022




ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE



PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KORPORATAVE

Tetor - Dhjetor 2022



Zhvillimi i qëndrueshëm është harmonizimi i zhvillimit ekonomik dhe mbrojtja e mjedisit për të plotësuar nevojat e sotme, pa rrezikuar mundësitë që edhe brezat e ardhshëm t`i shfrytëzojnë këto kapacitete dhe t`i përmbushin nevojat e veta.





MARATONA E TIRANËS 2022

Bankat nxisin punonjësit e tyre të jetë pjesë e aktiviteteve që promovojnë një jetë të shëndetshme dhe rrisin ndërgjegjësimin për reduktimin e përdorimit të mjeteve motorike.

Banka Kombëtare Tregtare, Intesa Sanpaolo Bank Albania, OTP Bank Albania dhe Raiffeisen Bank Shqipëri, më 23 tetor 2022 iu bashkuan edicionit të 6-të të Maratonës së Tiranës, dhe vrapuan midis 2,500 pjesëmarrësve nga 33 vende të botës.



PANELET FOTOVOLTAIKE

Raiffeisen Bank është ndër bankat e para që instalon panele fotovoltaike për kursimin / prodhimin e energjisë. Falë këtij projekti arrihet një nivel mjaftueshmërie i prodhimit të energjisë prej 31%, duke kursyer 31% energji dhe duke shmangur 84,000 kg/vit dioksid karboni të emetuar në atmosferë.

Më datë 5 tetor 2022, **Intesa Sanpaolo Bank Albania** mikpriti bashkëpunëtorët dhe partnerët e biznesit në një event të dedikuar ndaj biznesit. Gjatë takimit u prezantuan mundësitë e financimit për investimet e gjelbra të bizneseve, kryesisht për investimet në panele fotovoltaike me kushte financiare lehtësuese. Banka nxit klientët vendas të bëjnë investime në ndërtesa banimi ekologjike dhe promovon Qiranë Financiare për automjetet elektrike.

Banka ProCredit

- ▶ Mirëpriti në një forum mbi 200 biznese të interesuara për të kryer investime në panele fotovoltaike. Të ftuar ishin dhe partnerë strategjikë, si Ministria e Energjetikës, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, si dhe shoqëri projektuese dhe zbatuese të paneleve fotovoltaike.
- ▶ Si një ndër partnerët kryesorë të panairit AgroTech Expo 2022, organizuar në Ekspocity, banka u angazhua në informim dhe këshillim të investimeve në panele fotovoltaike për çdo agrobiznes që synon të zhvillohet në mënyrë të qëndrueshme.
- ▶ ProCredit Shqipëri së bashku me ProCredit Kosovë dhe Serbi, morën pjesë në Samitin e 5-të Vjetor Ndërkombëtar dhe Ekspozitën për energjinë në Turqi dhe Ballkan 2022, të zhvilluar në 26 dhe 27 tetor 2022, në Ankara. Fokusi i këtij samiti ishte rritja e investimeve në energjinë e rinovueshme.

Banka OTP Albania mori pjesë në panairin e energjetikës dhe ofrimin e produkteve lehtësuese për klientët. Panairi u zhvillua në muajin nëntor.





Stafi i **Banka Kombëtare Tregtare** realizoi ngjitjen e Malit me Gropa në lartësinë prej 1,847 metra mbi nivelin e detit.

Credins Bank mbështeti “Climathon Tirana 2022”. Aktiviteti synonte mbështetjen e 100 të rinjve novatorë me fokus përmirësimin e qëndrueshmërisë dhe ndërgjegjësimin ndaj ndryshimeve klimaterike për t’i dhënë zgjidhje 5 sfidave klimaterike të qytetit të Tiranës.






DHURIMI VULLNETAR I GJAKUT

Një nismë që organizohet prej vitesh me pjesëmarrjen vullnetare të stafit të bankave për t'u ardhur në ndihmë fëmijëve talasemikë.

Banka Amerikane e Investimeve dhe Intesa Sanpaolo Bank Albania.



Banka Amerikane e Investimeve


- ▶ Mbështeti Qendrën Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijë në Tiranë, si një institucion publik i specializuar në fushën e shëndetit mendor dhe fizik. Projekti synoi përmirësimin e mjediseve fizike të institucionit për të garantuar një cilësi shërbimi më të mirë të mjediseve terapeutike.
- ▶ Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Shkopit të Bardhë, më 15 tetor, banka mbështeti koncertin e organizuar nga ansambli i vokalit "Joy of Singing", me qëllim aktivizimin në jetën artistike të personave me aftësi të kufizuara në shikim dhe ofrimin e shanseve të barabarta për integrimin e këtij komuniteti në shoqëri.
- ▶ Në cilësinë e sponsorit gjeneral, mbështeti eventet e organizuara në Vlorë, për 110-vjetorin e Pavarësisë Kombëtare.

Banka Kombëtare Tregtare

- ▶ Nën moton "Mos neglizho, gjej kohën dhe kujdesu për veten!", ndërmori një sërë nismash për të rritur ndërgjegjësimin për parandalimin e kancerit të gjirit. Krahas mesazheve në rrjetet e saj sociale, banka dhuroi fjongo rozë për të gjithë stafin si edhe organizoi një takim të hapur me mjekun onkolog Dr. Alketa Curri.
- ▶ BKT iu bashkua nismës vjetore të UN Women Albania "16 Ditë Aktivizim kundër Dhunës me Bazë Gjinore". Duke filluar nga data 25 nëntor, Dita Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave, dhe deri më 10 dhjetor, banka shpërndau në rrjetet e saj sociale dhe rrjetin e ATM-ve, video dhe mesazhe ndërgjegjësuese kundër dhunës, si edhe ndryshoi ngjyrën e logos në portokalli, ngjyra që shoqëron këtë fushatë dhe simbolizon një të ardhme të ndritur dhe pa dhunë për gratë.
- ▶ Po në kuadër të fushatës, BKT mbështeti financiarisht strehën e grave në Elbasan nën kujdesin e shoqatës "Forumi i Gruas".

Credins Bank

- ▶ Mbështeti aktivitete kulturore:
 - » Festivalin "Rhythm that unites", në bashkëpunim me zyrën e United Nations dedikuar të rinjve për të promovuar mesazhe dhe vlera që na bashkojnë: integriteti, punësimi, barazia gjinore, mjedisi etj., për një zhvillim të qëndrueshëm të të gjithë shoqërisë;
 - » Edicionin e parë të "Festivalit Ndërkombëtar të Dancit Bashkëkohor" i cili u mbajt në Teatrin e Operës dhe Baletit.
- ▶ U gjend pranë shtresave në nevojë duke dhuruar dhe organizuar aktivitete:
 - » Mbi 70 pako ushqimore u shpërndanë në Shkodër për shoqatën e Para Tetraplegjikëve. Tradita e Bankës Credins "Food bank" vazhdon prej dy vitesh.





- » U dhuruan libra në bibliotekën e fëmijëve në qytetin e Korçës.
- » U shpërndanë 50 pako ushqimore tek familjet më në nevojë në periferi të Tiranës.
- » Fëmijët e stafit të Credins Bank, në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar, organizuan një festë me tematikë “Një dhuratë për ty”.
- » U organizua një drekë për 50 persona të Qendrës Sociale “Gonxhe Bojaxhi”.
- » U gjend pranë 51 fëmijëve me çrregullime të spektrit të autizmit pranë fondacionit “Fëmijët Shqiptarë” ku në një atmosferë festive u shpërndanë dhurata për ta.

Fibank Albania






- ▶ Në partneritet me Mother and Child Hospital Foundation dhe UNFPA, në kuadër të 16 ditëve të aktivizmit kundër dhunës ndaj grave dhe në prani të përfaqësuesve nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Bashkia Tiranë, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si dhe partnerëve zbatues nga institucione shtetërore dhe shoqëria civile, Fibank Albania ishte pjesë e hapjes së ekspozitës me fotografi të vajzave shqiptare dhe siluetave të atyre vajzave që mungojnë mes nesh. Ekspozita u zhvillua në Pedonalen e Tiranës deri në datën 18 dhjetor dhe ishte e hapur për të gjithë.
- ▶ Në Shqipëri lindin 109 djem për çdo 100 vajza. Për çdo 10 djem të lindur, humbasim një vajzë. Sipas kësaj përlllogaritjeje, në Shqipëri, vetëm në një dekadë, kemi rreth 21,000 “vajza që mungojnë” nga moshja 0-19 vjeç. Kjo dukuri krijon një zinxhir pabarazie gjinore, që prek çdo sferë të shoqërisë tonë.

Intesa Sanpaolo Bank Albania

- ▶ Në bashkëpunim me Ambasadën Italiane mbështeti ndeshjen e futbollit “Partita del Cuore” e cila pati qëllim mbledhjen e fondeve për bamirësi. Ky aktivitet sportiv u zhvillua më datë 11 tetor 2022, në stadiumin “Selman Stërmasi”. Fitimi nga shitja e biletave shkoi në ndihmë të OJF-ve: “Sanita di Frontiera” dhe “Comunità di San Giuseppe”.
- ▶ Muaji tetor është Muaji i Ndërgjegjësimit për Kancerin e Gjirit. Stafit të bankës iu mundësua një material edukativ dhe informues i përgatitur nga Medical Response for Diplomatic Corps (MRDC), i cili përmbante informacione dhe të dhëna, përfshirë kontrollat e nevojshme periodike, si dhe faktorët e rrezikut që ndikojnë tek kanceri i gjirit.
- ▶ Më datë 24 tetor, në ambientet e degës së bankës pranë Zyrave Qendrore, u mundësua një “Photo Booth” kushtuar fushatës sensibilizuese për kancerin e gjirit.

OTP Bank Albania

- ▶ Me rastin e festave të fund vitit, Banka OTP Albania ka kontribuar në shpërndarjen e ndihmave ushqimore për disa familje në nevojë, në Tiranë dhe rrethe.
- ▶ Në një seri eventesh disa ditore, banka ka mbështetur Festivalin “Hungarissimo” që u zhvillua në Tiranë, Fier dhe Korçë. Festivali nisi me hapjen e ekspozitës së dy artistëve hungarezë përgjatë zonës së Pedonales, dhe vijoi me një sërë ngjarjesh kulturore për publikun e gjerë. Banka ofroi dhe dhurata për pjesëmarrësit dhe fituesit.
- ▶ Nën një koreografi e cila ndërthurte tradicionale me modernen, Qendra “Ti” solli në sheshin Skënderbej dhjetëra balerinë të rinj të cilët performuan për publikun. Nën sloganin “Muzika dhe vallëzimi, dy gjuhët e vetme që i flasin të gjithë!” Banka OTP Albania sponsorizoi zhvillimin e aktivitetit.
- ▶ Në muajin tetor, Bashkia e Tiranës organizoi aktivitetin e përvitshëm të #mirësevjen party. Ky aktivitet ka në fokus të tij të mirëpresë studentët të cilët do të kryejnë studimet universitare në Tiranë. Në një panair-festë përgjatë gjithë ditës u ftuan organizata rinore, të cilat shpallorin hapësirat që kanë për të rinjtë si edhe projektet ku mund t’i përfshijnë, bisedë për startup-e dhe prezantimin e inkubatorëve në vend.





- ▶ Gjatë kohëve të vështira për të gjithë botën, të cilat u krijuan për shkak të luftës Rusi-Ukrainë, Banka OTP Albania ka ofruar mbështetje për të strehuar dhe ndihmuar një numër të konsiderueshëm qytetarësh nga Ukraina.

Procredit Bank Shqipëri


- ▶ Uroi festat tek partnerët e saj nëpërmjet kartolinës së krijuar nga Rean, një fëmijë 9 vjeçar i cili është pjesë e organizatës "Down Sindrom Albania". Fondet e mbledhura nga blerja e imazhet e punuara me dorë nga fëmijët e këtij institucioni, shkojnë për mbulimin e një pjese të shpenzimeve terapeutike për këta fëmijë.
- ▶ Në ditën e kursimit banka organizoi orë të hapura mësimore në disa shkolla 9 vjeçare në Tiranë. Përfaqësues të bankës shpjeguan rëndësinë e kursimeve dhe nxitën fëmijët të mendojnë mënyra si mund të kursejnë nga pak çdo ditë.

Raiffeisen Bank Shqipëri

- ▶ Nëpërmjet ë nismës Kujdesemi me zemër u realizuan 5 projekte duke iu gjendur pranë familjeve në nevojë, veçanërisht fëmijëve:
 1. Në qytetin e Shkodrës mundësoi festat dhe dhurata për 40 fëmijët e akomoduar në të dy Shtëpitë e Fëmijës. Gjithashtu u mundësua ngrohja e sallave të studimit si dhe blerja e dyshekëve të rinj.
 2. Dhuroi 250 pako me ushqime për disa nga familjet më në nevojë në Njësinë Bashkiake nr.1 në Tiranë.
 3. Teatri me Kukulla "Vajza e luleve" për fëmijët në nevojë në 10 qendra sociale.
 4. Nëpërmjet fondacionit të Stepic CEE Charity, me qendër në Vienë iu gjend pranë fëmijëve në Ukrainë, të cilët janë të privuar për të jetuar magjinë e festave dhe për më tepër kanë të paplotësuar nevojat më bazike të jetesës.
 5. Stafi i bankës në drejtorinë qendrore dhuroi në mënyrë vullnetare veshje dhe lodra për nënat dhe fëmijët në qendrën sociale të Bregut të Lumit në Tiranë.
- ▶ Gjatë muajit tetor, në kuadër të sensibilizimit ndaj kancerit të gjirit, si pjesë e programit "RBAL Wellness" u organizua një bisedë e hapur dhe informuese me mjekun senolog-onkolog Dr. Helidon Nina.
- ▶ Mbështeti aktivitetet e ndryshme kulturore dhe sportive, si Javën kulturore austriake në 17-23 tetor, dhe Check In Fest në Tiranë në 19 nëntor.
- ▶ Në vijim të mbështetjes së projekteve në ndihmë të komunitetit, Raiffeisen ka bërë të mundur rikonstruksionin dhe mobilimin e pavijonit të pediatriisë në spitalin e qytetit Sarandë, si dhe dhuroi pajisje kompjuterike të gjeneratës së re për Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës.
- ▶ Sërish mbështeti konkursin Elevator Lab, programin e partneritetit me Raiffeisen Bank International, në edicionin e tij të gjashtë nën sloganin "Përtej Sfidës", ku 8 startup-et finaliste prezantuan para qindra të ftuarve në Demo Day, produktet dhe shërbimet e tyre duke konkurruar për çmimin e madh prej 5,000€, por dhe mundësisë së bashkëpunimit me Raiffeisen Bank.

Union Bank

- ▶ Mbështeti konkursin "Ndërto të Ardhmen" për diplomat më të mira të studentëve të Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës, i cili u organizua gjatë panairit "Build and Live Smart Expo 2022" organizuar nga Expocity Albania.
- ▶ Mbështeti aktivitetin "Festojmë së bashku Krishtlindjen" i cili u zhvillua në formën e një maratone performancash artistike me pjesëmarrje të grupeve të fëmijëve dhe të rinjve artistë nga shkollat dhe qendrat artistike të Tiranës.



Intesa Sanpaolo Bank Albania

- ▶ Më datë 14 dhjetor, një grup nxënësish nga gjimnazi “Turgut Ōzal” Tiranë vizituan ambientet e Zyrave Qendrore të Intesa Sanpaolo Bank Albania. Këta nxënës ishin pjesë e klubit “Young Economics” dhe morën pjesë në një takim të hapur me drejtuesit e lartë të departamenteve të ndryshme të bankës.



ProCredit Bank

- ▶ Në mbështetje të bizneseve të vogla dhe të mesme në sektorin e industrisë ushqimore, Procredit Bank Shqipëri ishte pjesë e panairit “Green Fest 2022”, organizuar në Sheshin Skënderbej nga Bashkia Tiranë. Këshilluesit e Biznesit të ProCredit Bank ishin të pranishëm në panair për të dhënë informacion mbi produktet dhe incentivat e bankës të krijuara dhe dedikuara për këto biznese.



Union Bank

- ▶ Union Bank solli në muajin tetor, për herë të parë në treg, Kartën e Studentit 2 në 1 në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës dhe Agjencinë e Rinisë pranë saj. Ky është një produkt inovativ që ofrohet për herë të parë për studentët, dhe është kartë debiti dhe kartë studenti njëkohësisht, e cila u vjen në ndihmë studentëve që ta përdorin atë si kartë debiti si pagesa, blerje, etj., si dhe të përfitojnë nga uljet që ofron si Kartë Studenti.
- ▶ Mbështetëse e çmimeve për tre skuadrat fituese me idetë më të mira të prezantuara në “Good Start UP School” Shkodra, zhvilluar me pjesëmarrjen e të rinjve nga 5 bashkitë e Qarkut Shkodër. Qëllimi i këtij aktiviteti ishte fuqizimi i të rinjve drejt sipërmarrjeve të suksesshme dhe përgatitja e tyre, dhe nxitja e rritjes së bizneseve të reja dhe absorbimit të metodologjive dhe praktikave më të mira të vendeve evropiane.
- ▶ Union Bank ishte Gold Partner dhe pjesëmarrëse në panairin AgroTech Expo 2022, ku dhe prezantoi të gjitha produktet e dedikuara që banka ofron për të gjithë sektorin Agro, për të qenë sa më pranë nevojave të agrobizneseve dhe fermerëve, për investim dhe zgjerimin e aktivitetit të tyre.

